

A është ky program për mua?

➤ A kam energji dhe vullnet të mësojë gjuhën gjermane deri në nivelin B2?

➤ A jam i ndjeshëm dhe me pëlqen të merrem me njerëz të moshave të ndryshme?

➤ A jam i interesuar për infermieri, detyra mjekësore dhe sociale?

➤ A kam guxim të kujdesem dhe të mbikqyrë njerëzit me nevoja të ndryshme?

➤ A mund të merrem nga afër me njerëz të semurë dhe nevojtarë?

➤ A jam i gatshëm të përgatisë dokumente administrative për planifikim si dhe të kujdesem për dokumentacionin?

➤ A mund të punojë në mënyrë të pavarur por edhe në ekip?

Çka ju ofrohet?

➤ Migrim legal, i sigurtë dhe transparent.

Mbulim i kostos së provimit B1, B2 dhe rreth 50% të kostos së përgjithshme të kursit të gjuhës gjermane.

➤ Mbështetje administrative dhe financiare për të gjitha proceset, si: njohja e kualifikimit, administrimi i vizave, udhëtimi në Gjermani.

Kush jemi ne?

APPK është lider në fushën e ri-integrimit socio-ekonomik dhe ngritjes së kapaciteteve të grupeve të ndryshme synuese, duke siguruar qëndrueshmërin socio-ekonomike dhe avancimin profesional të tyre, me qëllim të ndikimit në zhvillimin ekonomik dhe stabilizimin e përgjithshëm të komunitetit.

Si mund të na kontaktoni?

✉ info@appk.org

☎ +383 (0)38 55 41 55, 383 (0)38 55 41 66
+383 (0)44 507 628

🏠 Rruga Rexhep Krasniqi, nr.59,
Kalabri, Prishtinë, Kosovë

🌐 www.appk.org

📌 www.fb.com/appkorg



AUSBILDUNG

Infermier i diplomuar në
Gjermani



Çka është Programi Ausbildung?

Programi Ausbildung, apo ndryshe Shkollim dhe Aftësim Profesional në Gjermani, është sistem i arsimit dual, ku përfshihen teoria dhe praktika. Ausbildung zhvillohet në shkollë dhe institucionet e Ausbildung. Gjatë kryerjes së Ausbildung, kandidatët marrin kompensim mujor.

Ausbildung njihet jo vetëm në Gjermani, por ne të gjitha shtetet e Bashkimit Evropian.

Cilat janë kriteret e pjesëmarrjes?

Ju jeni të interesuar të përfundoni një Ausbildung 3-vjeçar në Gjermani.

Ju jeni të interesuar të punoni në fushën sociale sepse ju pëlqen të punoni me njerëz.

Ju jeni mbi moshën 18 vjeçare, dhe keni të përfunduar shkollimin e mesëm për Mjekësi apo Gjimnaz.

Ju jeni të gatshëm të investoni për mësimin e gjuhës gjermane deri në nivelin B2. Ausbildung-un mund ta filloni vetëm pasi të zotëroni njohuritë e gjuhës gjermane të nivelit B2.

Ju jeni të gatshëm të mbikëqyrni dhe kujdeseni për të sëmurët, të moshuarit dhe njerëzit që kanë nevojë për kujdes.

Ju jeni tolerant dhe të hapur për të punuar në ekipe ndërkombëtare.

Cilat janë fazat e programit?

Ftesa për Aplikim

- Aplikimi online, me diplomën e shkollës së mesme, drejtimi Mjekësi apo Gjimnaz.
- Biseda Prezantuese.
- Vendimi për pranueshmerinë në program.

Mësimi i gjuhës gjermane

- Mësimi i gjuhës gjermane deri në nivelin B2, si kriter kryesor për fillimin e Ausbildung në Gjermani.

Njohja e dokumenteve

- Njohja e dokumenteve të shkollës së mesme.
- Kontrata për Ausbildung.

Viza

- Procedura e vizave dhe udhëtimi në Gjermani, për të filluar Ausbildung 3 vjeçar.

Kush janë partnerët dhe ku zhvillohet Ausbildung?

Që nga viti 2014, APPK implementon programin për Shkollim dhe Aftësim Profesional në Gjermani. Programi realizohet në bashkëpunim me partnerët në Gjermani, në 4 Republika të Gjermanisë:

- **DIAKONIE**
Republika e Baden-Württemberg
- **CEB AKADEMI**
Republikat Saarland
- **COBURG**
Komuna Coburg (Bayern)
- **ADLER MANAGEMENT UG**
Republika Brandenburg
- **AWO - Würzburg**
Bayern
- **MEDIZIN MOBIL**
Regjioni Hannover

